

# SHOQERIA TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

ME ORTAKERI

**" KASTRIOTI & PETROL " Shpk**

Durres – A L B A N I A

## KONTRATE THEMELIMI

Ne Durres, sot me daten 07 Shkurt 2006, (dymije e gjashte) dite e Marte, ne shtetasit shqipetar me keto Identitetet:

**1. Z. KUJTIM ÇAUSHILLARI**, atesia Xheviti, amnesia Sabike, i datelindjes 10.11.1952, lindur ne Korce dhe banues ne Tirane, shtetas shqipetar, identitetin e te cilit e verifikova me Certifikaten e Lindjes me foto seria 372 680497, Nr. 5-87 date 07.02.2006, leshuar nga Zyra Gjendjes Civile Njesia 9 Tirane, dhe

**2. Z. MUJO NERGUTI**, atesia Gafur, amnesia Dalie, i datlindjes 02.04.1965 lindur ne Gjegjan Kukes dhe banues ne Durres, shtetas shqipetar, identitetin e te cilit e verifikova me Pasaporten Nr. Z0467505 me afat deri me 13.04.2013, bazuar ne:

\* Vullnetin tone te lire, te plote, te sinqerte dhe ne inisiativen e lire private,

\* Ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi,

\* Ne Ligjin Nr.7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare",

\* Ne Ligjin Nr.7667 date 28.01.1993 "Per Rregjistrin Tregtar "ate Doganor, Fiskal, Tatimor

\* Ne Ligjin Nr.7764 date 02.11.1993 "Per Investimet e huaja" dhe ne te Drejten nderkombetare Publike dhe Konventat nderkombetare te gjithepranuara te **Komunitetit European** me anen te ketij **Akti Themelimi**, krijoj **Shoqerin me Ortakeri** dhe me perjegjesi te kufizuar **"KASTRIOTI & PETROL"** Shpk Durres

### NENI 1

Krijohet Shoqeria tregtare, me ortakeri, vendase me emrin

**"KASTRIOTI & PETROL" Shpk**

Durres Albania, emertim i cili do te jete i stampuar dhe ne vulen e saj.

### NENI 2

**"Selia Qendrore e Shoqerise eshte ne qytetin e Durrenit ne Adresen:**

L. 13, Plepa Plazh Durres – Albania

### NENI 3

Shoqeria shtrin aktivitetin e saj tregetar ne te gjithe juridiksonin territorial te Republikes Shqiperise si dhe jashte shtetit.

Me Vendim unanim te Ortakut mund te krijohen ose anullohen (ne rast se jane çelur) Seli, Filiale, Agjensi dhe Perfaqesi si ne qytete te tjera te Shqiperise dhe ne Itali apo shtet tjeter te Komunitetit European apo shtet tjeter te huaj.

Njesite e tjera Strukturore te Shoqerise, si Dege apo Perfaqesi dhe jashte shtetit krijojen kur nje gje te tille e parashikon dhe lejon dhe legjislacioni i vendeve te huaja normat e se drejtes nderkombetare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve te ndryshme.



#### NENI 4

**Kapitali Themeltar** i Shoqerise eshte ne likuditet ne monedhe vendi ne shumen **500.000 LEK** (peseqindemije) Leke, i ndare ne **500 kuota** me vlore nominative **1 kuote/1000 Lek**, i depozituar ne Banke, i formuar dhe nenshkuar ne menyre te barabarte nga Ortaket themelues, dhe konkretisht:

1. **Z. Kujtim Çauhillari** ne shumen **250.000 Lek** e barabarte, me **250 Kuota** qe zene **50%** te Kapitalit, ku nje kuote eshte e barabarte me **I vote me te drejte vendimore**.

2. **Z. Mujo Nerguti** ne shumen **250.000 Lek** e barabarte me **250 Kuota** qe zene **50 %** te Kapitalit, ku nje kuote eshte e barabarte me **I vote me te drejte vendimore**.

Ortaku ka pavaresi ligjore, organizative si dhe te drejta pronesie mbi çdo lloj Kapitali, mjete xhiroje apo çdo lloj pasurie tjeter (te luajteshme apo te paluajteshme), te fituar ne rruge te ligjeshme. Shoqeria perjigjet vetem me Kapitalin e saj.

#### NENI 5

Kapitali nuk mund te jete kurre i perfaqesuar me Letra me vlore dhe derdhja e Kapitalit themeltar te Shoqerise, behet para kerkeses se drejtar Gjykates per njohjen dhe rregjistrimin e saj si Person Juridik.

#### NENI 6

**Kohezgjatja** e ushtrimit te aktivitetit te Shoqerise eshte **PA AFAT**, duke filluar ky afat nga dita e shpalljes Vendimit te Gjykates Tirane, per njohjen dhe rregjistrimin e Shoqerise si Person Juridik.

Me Vendim te Ortakeve, kohezgjatja ushtrimit te aktivitetit te Shoqerise mund te ndryshoj, dhe ky Vendim dergohet menjehere per depozitim Gjykates kompetente per te bere shenimet e nevojshme ne Rregjistrin e Shoqerive Tregtare.

#### NENI 7

Shoqeria e zhvillon veprimtarin e saj tregtare ne perputhje te plete me Legjislacionin shqipetar ne fuqi, Konventat nderkombetare te gjithepranuara si dhe mbi bazen e ketij Akti Themelimi dhe Statutit te saj.

#### NENI 8

Shoqeria çel Llogari Bankare ne lek vendi dhe çdo lloj valute, ne Banka vendase ose te huaja, private apo shteterore, me qellim per te kryer veprimet e nevojshme per ushtrimin dhe perballimin Statutit te saj.

**Ortaket themelues** dhe **Administratorret e Pergjithshem** te caktuar ne kete Akt Themelimi dhe Statutin e Shoqerise, depozitojne faksimilet e firmes originale ne Bankat ku eshte çelur llogaria dhe terheqja e pjeseve te Kapitalit behet kur Çeku bankar eshte firmosur nga njeri prej Ortakeve ose Administratori i Pergjithshem, ose perfaqesuesi ligjor i emeruar me Prokure te Posacme, vetem per veprimtarin e zakoneshme ekonomiko financiare dhe operative te Shoqerise, sikurse jane kryerja pagesave, likudimeve detyrimeve fiskale, tatimore, doganore, sigurimeve Shoqerore e shendetesore, TVSH.

**Ndersa** ne rastet e kryerjes **veprimtarive te rendesishme** qe kane te bejne me shpenzime ne vlera te medha dhe te jashtezakoneshme qe lidhen me transaksione qe kane te bejne me blerje te pasurive te paluajteshme, shkembime apo cdo lloj tjetersimi te tyre, zmadhime te kapitalit ne likuiditet apo ne natyre, venie garancie hipotekore apo bankare, ato per celje dhe marrje kredie, per marrje pjesë ne tendera brenda vendit apo nderkombetare, **Ortaket** qe kane dhe cilesin e Administratoreve te Pergjithshem **kryejne cdo lloj veprimi bankar**, per ushtrimin e aktivitetit tregtar te shoqerise, sa here qe eshte e nevojshme.

Administrator i Pergjithshem i Shoqerise caktohet ortaku themelues:

**I. Z. MUJO NERGUTI**, atesia Gafur, amesia Dalie, i datlindjes 02.04.1965 hindur ne Gjegjan Kukes dhe banues ne Durres, shtetas shqipetar, identitetin e te cilit e verifikova me Pasaporten Nr. Z0467505 me afat deri me 13.04.2013.

### NENI 9

**Pjeset e Kapitalit Themelor**, jane lirisht te transferueshme ne rruge trashgimie ligjore ose testamentare, sipas dispozitive te Kodit Civil, dhe ortaket gezojne te drejten e shitjes se kuotave ne mes tyre ose jashte ortakerise, mbi bazen e vendimit te Asamblese Ortakeve dhe sipas procedurave qe jane percaktuar ne Statutin e Shoqerise.

Ortaket kane te drejte te transferojne jashte territorit te Republikes se Shqiperise pjeserisht ose teresisht kontributet e tyre, perfshire dhe fondeve dhe vlerat e kontributit ne Natyre ose **nepermjet fitimit te realizuar** bazuar ne te drejten qe u njeh neni 7 Ligjit Nr.7764 date 02.11.1993 "Per Investimet e Huaja".

**Transferimet e pjeseve te Kapitalit Themelor**, duhet te jene te vertetuara me **Akt Notarial** dhe per nje gje te tille Ortaket duhet te marrin paraprakisht Vendim me shkrim.

**Shoqeria** dhe te tretet, respektive keto Transferime sapo tu behen te ditura.

### NENI 10

Me Vendim te Ortakeve, ne dispozicion te Shoqerise mund te vihen FONDE te tjera duke perfshire dhe shtesa me ane te **KAPITALIT** ne natyre

### NENI 11

Ortaket kane te drejte, qe pas shlyerjes se detyrimeve ndaj te treteve, detyrimeve ligjore te Sistemit te taksave dhe atij fiskal dhe ruajtjes se Fondit Rezerve, FITIMIN NETO ta ndajne ne mes tyre mbi bazen e kontributit ne krijimin e Kapitalit themeltar dhe si te kene marre me pare VENDIM me Shkrim ne Mbledhjen e Asamblese se Ortakeve, per sasine dhe kohen e shperndarjes se dividentit.

### NENI 12

**Shoqeria krijohet per te ushtruar aktivitetin e saj tregetar ne keto Drejtime:**

**1. Import – Eksportin** dhe tregetimin **me PAKICE** te karburanteve, lubrifikanteve, lendeve djegese te lengeshme dhe te GAZTE si brenda vendit dhe jashte shtetit.

**2. Tregetimin** me shumice e pakice dhe import – eksport te mallrave te ndryshem industriale, ushqimore, buqesor, blektoral ,materialeve te ndertimit dhe te teknologjive te ndryshme etj

**3. Çeljen** dhe ushtrimin e aktivitetit te transportit, nepermjet transportit te brendshem dhe atij nderkombetar, duke e realizuar me ane te transportit vendas dhe nderkombetar, per pasagjere, mallrave te cdo lloji, te parashikuar dhe lejuar nga ligji, nepermjet komunikacionit tokesor, detar dhe ajror, me mjete e veta ose te te treteve, celjen dhe funksionimin e agjencive spacionere dhe Turistike, zhvillimin e aktivitetit te sherbimit social privat, me ane te Hoteleve, Bar-Restoranteve, etj.

**4. Çeljen** dhe **ushtrimin** e aktivitetit te serviseve per distributore dhe tregetimin pjeseve te kembimit per to, shitblerje te automjeteve te cdo lloji e tonazhi, dhenien e assistences teknike per sherbimin teknik te tyre, shitblerjen e pjeseve te kembimit per automjete, lyerjen e tyre, krijimin e parkingjeve e lavazhere.

**5. Ndertimin e objekteve civile**, industriale, turistike, buqesore, ndertime banesash, punime montimi ne impiante te prodhimit dhe shperndarjes se energjise, punime ne siperfaqe te gjelbertaparqe e pyje, restaurime te ndertesave dhe ne vepra arkeologjike, punime per ndertimin e rrugeve dhe te autostradave, te linjave hekurudhore, ne porte dhe aeroporte, kryerjen e sherbimeve komisionare, ate






te shitblerjes se pasurive te luajteshme e te paluajteshme si dhe administrimin e disponimin e tyre, sipas formave te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

**6. Marrjen** pjeze ne **Panaire** kombetare dhe nderkombetare, me qellim jo vetem ekspozimin e aktivitetit tregetar te Shoqerise por dhe per te mundesuar arritjen e marrveshjeve kontraktore me persona juridik vendas dhe te huaj per zgjerimin apo kooperimin e aktivitetit te perbashket tregetar me to, si dhe ne **tendera brenda** dhe **jashte vendit**.

#### NENI 13

Me Vendim te Asamblese Ortakeve, Shoqeria mund te zgjerohet duke pranuar nje ose me shume ortake te tjere, shtetas shqipetar apo te huaj, ose te bashkohet me nje Shoqeri tjeter tregetare si brenda vendit dhe jashte shtetit, te zgjeroj Objektin e veprimtarise se saj, te ndahet ne mirekuptim mes ortakeve ose ne rruge gjyqesore etj.

#### NENI 14

**Organ i larte Drejtues** dhe i vetem **Vendimor** i Shoqerise eshte **Mbledhja Asamblese Ortakeve** e cila ushtron te gjitha kompetencat qe i njeh Ligji Nr.7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare".

Sejcili Ortak mund t'ja delegoj kompetencat e tij, edo Ortaku tjeter ose nje apo me shume Administratoreve te caktuar me vendim te Asamblese se Ortakeve si dhe çdo Personi fizik shtetas shqipetar apo i huaj, mbi bazen e Prokures, te bere me akt notarial.

#### NENI 15

Me Vendim me shkrim te **Asamblese Ortakeve**, caktohet dhe shkarkohet **Administratori Pergjithshem** brenda ose jashte bashkesise se Ortakerise si dhe **Eksperti Kontabel i Autorizuar**.

#### NENI 16

Detajimi ne lidhje me problemet dhe administrimin e Kapitalit themeltar dhe te pjeseve nominative te tij, transferimi, zmadhimi ose zvogelimi i Kapitalit mbi bazen e kontributit te Ortakut te vetem, menrya e Drejimit Administrativ te Shoqerise, ajo e mbajtjes se llogarive dhe te Bilancit finansiar, zgjerimi i Shoqerise ose shndrimi i saj ne nje forme tjeter Shoqerie Tregtare, bashkimi me Shoqeri te tjera tregetare vendase apo te Huaja, ndarja apo menyrat e falimentimit te saj dhe kalimit ne Likuidim etj, percaktohen ne menyre me te specifikuar ne Statutin e Shoqerise.

#### NENI 17

Si rregull dhe per gjithisht Ortaku vetem drejton dhe zhvillon aktivitetin tregetar te Shoqerise me kompetence profesionale dhe ligjore dhe ne rast lindje te konfliktit me te tretet ne pamundesi te zgjidhes se mosmarrveshjeve me mirekuptim ai mund te kerkoj zgjidhjen e konfliktit, administrativ, civil tregtar, etj, ne rruge gjyqesore, duke ngritur Padil ne Gjykaten e rrithit Durrës si dhe ne **Gjykaten Nderkombetare te Parisit**.

*Auf*

*Jasmin*

05.

**NENI 18**



Kjo Kontrate Themelimi u redaktua ne 5 ekzemplare ne gjuhen shqipe, me permbajtje e vlera te njenja juridike dhe pasi lexohet, miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket themelues te Shoqerise tregetare "KASTRIOTI & PETROL" Shpk, dhe nenshkruehet prej tyre ne te gjith ekzemplaret duke vene emri, mbiemri dhe firma originale, autenticiteti i te cilave vertetohet dhe nga Noteri.

**ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE TREGTARE**

**"KASTRIOTI & PETROL" Shpk**

Durres - Albania

**Miratues te kesaj Kontrate Themelimi**  
Shtetasit Shqipetar

1. z. Leyhm Gashi

2. z. Mijo Negutti

# SHOQERIA TREGTARE VENDASE ME ORTAKERI

ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

## “KASTRIOT & PETROL” Shpk

DURRES – A L B A N I A

### S T A T U T I

**KREU I:**

**EMERTIMI - OBJEKTI - SELIA - KOHEZGJATJA**

#### NENI 1

Eshte krijuar ne Durres, sot me daten **07 Shkurt 2006**, (dymije e gjashte), dite e Marte, nga ne Ortaket, shtetasit **Shqipetar** me keto Identitete :

**1. Z. KUJTIM ÇAUSHILLARI**, atesia Xhevrit, amesia Sabike, i datelindjes 10.11.1952, lindur ne Korce dhe banues ne Tirane, shtetas shqipetar, identitetin e te cilit e verifikova me Certifikaten e Lindjes me foto seria 372 680497, Nr. 5-87 date 07.02.2006, leshuar nga Zyra Gjendjes Civile Njesia 9 Tirane, dhe

**2. Z. MUJO NERGUTI**, atesia Gafur, amesia Dalie, i datelindjes 02.04.1965 lindur ne Gjegjan Kukes dhe banues ne Durres, shtetas shqipetar, identitetin e te cilit e verifikova me Pasaporten Nr. Z0467505 me afat deri me 13.04.2013, krijojme:

**Shoqerin Tregetare me Ortakeri, vendase, dhe me pergjegjesi te kufizuar, “Kastrioti & Petrol” Shpk Durres Shqiperi, emertim qe do te jete i stampuar dhe ne vulen e saj.**

#### NENI 2

**“Selia Qendrore e Shoqerise eshte ne qytetin e Durresit ne Adresen:**  
L. 13, Plepa, Plazh Durres - Albania

#### NENI 3

Shoqeria shtrin aktivitetin e saj tregetar ne te gjithe juridiksonin territorial te Republikes Shqiperise si dhe jashte shtetit.

Me Vendim te Ortakeve mund te krijohen ose anullohen (ne rast se jane çelur) Seli, Filiale, Agjensi dhe Perfaqesi si ne qytete te tjera te Shqiperise dhe ne Itali apo shtet tjeter te Komunitetit European apo shtet tjeter te huaj.

Njesite e tjera Strukturore te Shoqerise, si Dege apo Perfaqesi dhe jashte shtetit krijohen kur nje gje te tille e parashikon dhe lejon dhe legjislacioni i vendeve te huaja normat e se drejtes nderkombetare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve te ndryshme.

#### NENI 4

**Kapitali Themeltar** i Shoqerise eshte ne likuditet ne monedhe vendi ne shumen **500.000 LEK** (peseqindemije) Leke, i ndare ne **500 kuota** me vlore nominative **1 kuote/1000 Lek**, i depozituar ne Banke, i formuar dhe nenshkruar ne menyre te barabarte nga Ortaket themelues, dhe konkretisht:

02.

1. Z. KUJTİM ÇAUSHLLARI ne shumen valute **250.000 Lek** e barabarte, me ~~250 Kuota qe zene~~ ~~zene~~, **50 %** te Kapitalit, ku nje kuote eshte e barabarte me **I vote me te drejte vendimore**.

2. Z. MUJO NERGUTI ne shumen valute **250.000 Lek** e barabarte me **250 Kuota qe zene** **50 %** te Kapitalit, ku nje kuote eshte e barabarte me **I vote me te drejte vendimore**.

Ortaku ka pavaresi ligjore, organizative si dhe te drejta pronesie mbi çdo lloj Kapitali, mjete xhiroje apo çdo lloj pasurie tjeter (te luajteshme apo te paluajteshme), te fituar ne rruge te ligjeshme.

Shoqeria pergjigjet vetem me Kapitalin e saj.

## NENI 5

Kapitali nuk mund te jete kurre i perfaqesuar me Letra me vlore dhe derdhja e Kapitalit themeltar te Shoqerise behet para kerkeses se drejtuar Gjykates per njohjen dhe rregjistrimin e saj si Person Juridik.

## NENI 6

**Kohezgjatja e ushtrimit te aktivitetit te Shoqerise eshte per PA AFAT**, duke filluar ky afat nga dita e Shpalljes Vendimit te Gjykates Tirane, per rregjistrimin e Shoqerise si Person Juridik.

Me Vendim te Ortakut, kohezgjatja ushtrimit te aktivitetit te Shoqerise mund te ndryshoj, dhe ky Vendim dergohet menjehere per depozitim Gjykates kompetente per te bere shenimet e nevojshme ne Rregjistrin e Shoqerive Tregtare.

## NENI 7

Shoqeria e zhvillon veprimtarin e saj tregtare ne perputhje te plete me Legjislacionin shqipetar ne fuqi, Konventat nderkombetare te gjithepranuara si dhe mbi bazen e ketij Akti Themelimi dhe Statutit te saj.

## NENI 8

**Shoqeria krijohet per te ushtruar aktivitetin e saj tregetar ne keto Drejtime:**

1. **Import – Eksportin** dhe tregetimin **me PAKICE** te karburanteve, lubrifikanteve, lendeve djegese te lengeshme dhe te GAZTE si brenda vendit dhe jashte shtetit.

2. **Tregetimin** me shumice e pakice dhe import – eksport te mallrave te ndryshem industriale, ushqimore, bujqesor, blektoral ,materialeve te ndertimit dhe te teknologjive te ndryshme etj

3. **Çeljen** dhe ushtrimin e aktivitetit te transportit, nepermjet transportit te brendshem dhe atij nderkombetar, duke e realizuar me ane te transportit vendas dhe nderkombetar, per pasagjere, mallrave te cdo lloji, te parashikuar dhe lejuar nga ligji, nepermjet komunikacionit tokesor, detar dhe ajror, me mjete e veta ose te te treteve, celjen dhe funksionimin e agjencive spedicionere dhe Turistike, zhvillimin e aktivitetit te sherbimit social privat, me ane te Hoteleve, Bar-Restoranteve, etj.

4. **Çeljen dhe ushtrimin** e aktivitetit te serviseve per distributore dhe tregetimin pjeseve te kembimit per to, shitblerje te automjeteve te cdo lloji e tonazhi, dhenien e assistences tekniqe per sherbimin teknik te tyre, shitblerjen e pjeseve te kembimit per automjete, lyerjen e tyre, krijimin e parkingjeve e lavazheve.

5. **Ndertimin e objekteve civile**, industriale, turistike, bujqesore, ndertime baneshash, punime montimi ne impiante te prodhimit dhe shperndarjes se energjise, punime ne siperfaqe te gjelberta-parqe e pyje, restaurime te ndertesave dhe ne vepra arkeologjike, punime per ndertimin e rrugeve dhe te autostradave, te linjave hekurudhere, ne porte dhe aeroporte, kryerjen e sherbimeve komisionare, ate te shitblerjes se pasurive te luajteshme e te paluajteshme si dhe administrimin e disponimin e tyre, sipas formave te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

6. **Marrjen** pjese ne **Panaire** kombetare dhe nderkombetare, me qellim jo vetem ekspozimin e aktivitetit tregetar te Shoqerise por dhe per te mundesar arritjen e marrveshjeve kontraktore me persona juridik vendas dhe te huaj per zgjerimin apo kooperimin e aktivitetit te perbashket tregetar me to, si dhe ne **tendera brenda dhe jashte vendit**.

*L. Jashari*

*Curi*

03.

**NENI 9**

Shoqeria e fiton personalitetin juridik nga data e shpalljes Vendimit te Gjykatës Trejetarë Tirane per njohjen dhe Rregjistrimin e saj Person Juridik ne Rregjistrin tregetar te asaj Gjykatës.

Ushtimin e Aktivitetit tregetar te saj, e fillon pas te jete rregjistruar dhe paisur me Certifikatat perkatese ne Organin e Deges Tatim Taksave Durres .

**KREU II :**

**KUSHTET EKONOMIKE**

**NENI 10**

Shoqeria çel Llogari Bankare ne lek vendi dhe çdo lloj valute, ne Banka vendase ose te huaja, private apo shteterore, me qellim per te kryer veprimet e nevojshme per ushtrimin dhe perballimin financiar te aktivitetit te saj.

Ortaku vetem dhe Administratori Pergjithshem i caktuar ne kete Akt Themelimi dhe Statutin e Shoqerise, depoziton faksimilet e firmes originale ne Bankat ku eshte çelur llogaria dhe terheqja e pjesve te Kapitalit behet kur Çeku bankar eshte firmosur nga Ortaku vetem ose Administratori i Pergjithshem, ose perfaqesuesi ligjor i emeruar me Prokure te Posacme, vetem per veprimtarin e zakoneshme ekonomiko financiare dhe operative te Shoqerise, sikurse jane kryerja pagesave, likudimeve te detyrimeve fiskale, tatile, doganore, sigurimeve Shoqerore e shendetesore, TVSH.

Ndersa ne rastet e kryerjes **veprimtarive te rendesishme** qe kane te bejne me shpenzime ne vlera te medha dhe te jashtezakoneshme qe lidhen me transaksione qe kane te bejne me blerje te pasurive te paluajteshme, shkembime apo edo lloj tjetersimi te tyre, zmadhime te kapitalit ne likuiditet apo ne natyre, venie garancie hipotekore apo bankare, ato per celje dhe marrje kredie, per marrje pjesë ne tendera brenda vendit apo nderkombetare, **Ortaket** qe kane dhe cilesin e Administratorit te Pergjithshem kryejne edo lloj veprimi bankar, per ushtrimin e aktivitetit tregtar te shoqerise, sa here qe eshte e nevojshme.

**Administrator i Pergjithshem** i Shoqerise caktohet ortaku themelues dhe konkretisht:

I. Z. MUJO NERGUTI, atesia Gafur, amesia Dalie, i datlindjes 02.04.1965 lindur ne Gjegjan Kukes dhe banues ne Durres, shtetas shqipetar.

**NENI 11**

Pjeset e Kapitalit Themelor, jane ne likuiditet, nominative dhe lirisht te transferueshme ne mes ortakeve dhe rruge trashegimie sipas dispozitave te Kodit Civil.

Shitia apo transferimi i kuotave tek ortaket dhe te tretet behet me akt notarial.

Kapitali ndahet ne kuota, ku nje kuote ka vlore nominative 1000 Lek, ku nje kuote eshte e barabarte me te drejten e **I vote vendimore**.

**NENI 12**

Ortaket kane te drejte te transferojne jashte territorit te Republikes se Shqiperise pjeserisht apo teresisht Kontributet e tij perfshire dhe Fondet e Kontributet ne Natyre ose **nepermjet fitimit te realizuar** bazuar ne te drejten qe parashikon dhe lejon neni7 i Ligjit Nr.7764 date 02.11.1993 "Per Investimet e Huaja".

**Transferimet** e pjeseve te Kapitalit Themelor, duhet te jene te vertetuara me Akt Notarial dhe per nje gje te tille Ortaku duhet te marri paraprakisht Vendim.

Shoqeria dhe te tretet, duhet te respektojne keto Transferime sapo tu behen te ditura.

**NENI 13**

**Kapitali Themeltar i Shoqerise mund te rritet ose zvogelohet, mbi bazen e Vendimit me shkrim te marr ne mbledhjen e Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakut te vetem, duke u nenshkruar prej tij duke u bere autentifikimi nga ana e nje Noteri dhe dokumentohet duke bere dhe shenimet ne rregjistrin perkates.**

Çdo Vendim i Ortakeve per ndryshimin e Kapitalit themeltar i dergohet menjihere Gjykates kompetente qe e ka njojur dhe rregjistruar Shoqerin Person Juridik.

Me Vendim te Asamblese, ne dispozicion te Shoqerise mund te vihen dhe fonde te tjera financiare duke perfshire dhe shtesa me ane te Kapitalit ne Natyre.

**NENI 14**

**Zmadhimi Kapitalit Themeltar, mbi bazen e Vendimit me shkrim te Asambles jashtzakonshme behet kur Ortaket kane deklaruar, nenshkruar dhe derdhur pjesen e Kapitalit qe kerkojne te zmadhojne, si ne formen e Kontributit ne valute ose leke dhe ne natyre.**

Nuk konsiderohen zmadhim i Kapitalit themeltar, kontributet e sherbimeve.

Pas marrjes se vendimit per zmadhimin e Kapitalit Themeltar, Ortaket duhet te marrin vendim me shkrim dhe per te pasqyruar nje rrethane te tille ne Aktin e Themelimit dhe Statutin e Shoqerise, duke pasqyruar qarte kontributin ne likuiditet ose ne natyre te zmadhimit te kapitalit.

**NENI 15**

Ashtu sikurse dhe ne rastin e zmadhimit dhe kur behet *zvogelimi i Kapitalit* Themeltar, merret Vendim me shkrim nga Mbledhja e Asamblese Pergjithshme nga Ortaku vetem dhe zvogelimi i Kapitalit themeltar e prek Ortakun ne ate raport te pjeses se Kontributit qe ai perfaqeson ne krijimin e Kapitalit Themeltar.

Ne rastin kur Asamblea e Shoqerise, vendimin per Zvogelimin e Kapitalit themeltar e merr per shkakun se Humbjet e Shoqerise arrin nen limitin e parashikuar dhe lejuar nga Kodi Tregetar per Shoqerite me perqejgesi te kufizuar, krahas vendimit per zvogelimin e Kapitalit Themeltar, Ortaku duhet te marr Vendim dhe per te percaktuar :

- Nevojen e ndryshimit te formes juridike te Shoqerise, duke kaluar ne nje forme tjeter.
- Ndryshimin e Aktit te Themelimit dhe te Statutit te saj.
- Te bejne Publikimin dhe njoftimin e te treteve, me te cilet Shoqeria ka mardhenie kontraktore si dhe te Kreditoreve te saj.

**NENI 16**

Si ne rastin kur Ortaku, merr Vendim me shkrim, per zmadhimin ose zvogelimin e Kapitalit Themeltar, keto ndryshime duhen pasqyruar dhe ne Aktin e Themelimit dhe ne Statut dhe pasi te jene legalizuar per bazueshmerin ligjore dhe autenticitetin e nenshkrimive para nje NOTERI, i dergohen menjihere per depozitim Gjykates Rrethit Gjyqesor Tirane, per te bere shenimet e nevojshme ne Rregjistrin tregetar te Shoqerive Tregtare.



**KREU III**

**ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE DHE TE DREJAT DHE DETYRAT E**

**ORTAKUT**

**NINI 17**

**Organet Drejtuese te Shoqerise jane:**

1. Asamblea e Ortakeve (e zakonshme dhe e jashtezakoneshme).
2. Administratoret e Pergjithshem te Shoqerise.

**NINI 18**

**Mbledhja** Asamblese Ortakeve, eshte Organi i vetem me i larte Drejtues e **Vendimor** i Shoqerise dhe ushtron te gjitha kompetencat qe Ligji "Per Shoqerite Tregetare" i njeh Asamblese se Ortakeve qe jane krijuar me Ortakeri.

Ortaku kryen Drejtimin dhe Administrimin e Shoqerise, duke respektuar legjislacionin tregetar ne Fuqi si dhe te drejtat dhe detyrat e percaktuara ne Kontraten e Themelimit dhe ne kete Statut.

Ortaku mund t'ja delegoj Kompetencat nje ose me shume Administratoreve te caktuar me vendim te Asamblese se Ortakeve, si dhe nje Personi fizik jashte ortakerise se Shoqerise, shtetas shqipetar ose i huaj mbi bazen e Prokures, te bere me akt notarial.

**NINI 19**

Me Vendim te Ortakeve, Shoqeria mund te zgjerohet duke pranuar nje ose me shume ortake te tjere, shtetas shqipetar apo te huaj, ose te bashkohet me nje Shoqeri tjeter tregetare si brenda vendit dhe jashte shtetit, te zgjeroj Objektin e veprimitarise se saj etj.

**NINI 20**

**Ortaket e Shoqerise kane dhe keto te **drejta dhe detyra kryesore**:**

\* Te marrin pjese ne Drejtimin dhe administrimin e gjithanshem te veprimitarise ekonomiko tregtare te Shoqerise dhe te çdo veprimitarie tjeter te saj, kur ajo ushtroht ne perputhje me Ligjet Aktin e Themelimit dhe Statutin e saj.

\* Te kerkojne dhe ti jepen te gjitha Informatat qe kane te bejne me gjendjen tregtare dhe financiare te veprimitarise se Shoqerise, si dhe i te gjitha dokumentave te perpunuara nga Shoqeria, ato qe kane te bejne me nxjerrjen e rezultatit Ekonomik te Bilancit Kontabel apo per çdo llogarie te çelues, si te asaj Likuiduese dhe asaj Rrjedhse.

\* Te marrin pjese ne rezultatet e veprimitarise se Shoqrise ne cfaredo Forme apo sasi, sipas kontributit te dhene prej tij.

\* Te kryejne sherbime per realizmin e objektivave dhe qellimeve te veprimitarise se rregullt ligjore te Shoqerise.

\* Emerojne dhe shkarkojne ne çdo kohe Administratorin e Shoqerise, cakton Ekspertin Kontabel te autorizuar ose Administratorin e Shoqerise, ne rastin kur ka emeruar nje te tille per perqatitjen dhe nxjerrjen e Bilancit Vjetor ekonomiko finanziar te aktivitetit te Shoqerise, te cilin ata jane te detyruar



t'ia paraqesin Ortakeve mbi bazen e Raportit me shkrim dhe pas shqyrtimit te tij, Ortaket kane dhe te drejten e miratimit vendimor te ketj Bilanci.

Nxjerrja e Bilancit finanziar vjetor, mbi bazen e te dhenave dhe rregullave te Kontabilitetit behet brenda 6 muajeve nga mbyllja e vitit finanziar.

\* Ortaket, si kryesishet dhe me ane te Administratorit te emeruar prej tij dhe kur ky i fundit eshte i paisur me Prokure, ushtrojne dhe keto **TAGRA (te Drejta)**:

Mundesohen per te kryer te gjitha aktet dhe veprimet juridike qe konsiderohen se jane te domosdoshme per ushtrimin e gjithanshem dhe fitimprures te veprimitarise tregetare te Shoqerise sipas qellimeve dhe objektivave te saj sic mund te jene:

1. Te lidhin Kontrata te ndryshme qe kane per objekt Blerjen, shitjen, kembimin dhe marrjen me qera te Pasurive te ndryshme (te luajteshme dhe te paluajteshme) si me persona fizike dhe me Persona juridike vendas apo te Huaj si dhe me SHTETIN dhe ne rastin e blerjes te Pasurive te Paluajteshme apo marrjen e tyre me qera per nje kohe mbi 9 Vjet, duhet te bejne rregjistrimin ne Hipotekat e ZRPP te rrethit perkates si per transkriptimin e Pronesise ne favor te tyre apo kalimin e kesaj pasurie ne posedim ligjor.

#### **Çdo blerje e pasurive te mesiperme, konsiderohet dhe si shtese e Kapitalit ne Natyre.**

2. Te kryejne çdo lloj veprimi prane te gjitha Zyrave shteterore dhe Private, Bankat e çdo nivelit etj, qe kane te bejne me Garancite, Sipermarrjet, marrjen e Kredive, te Siguracioneve dhe Risiguracioneve per jeten dhe Demet, Transportit (brenda vendit dhe jashte shtetit) kryerjen e veprimeve doganore per zhdoganimin e mallrave te importuara apo deklarimin e atyre te eksportuar te plotesimit ne kohe dhe me rregullsi te dokumentacionit Fiskal, Tatimor, Bankar etj.

Ne rastet kur Veprimet juridike kryhen nga **Administratori emeruar nga Ortaket** themelues ose personi qe i Perfaqeson ata mbi bazen e Prokures, keta jane te detyruar qe ne perfundim te realizimit te veprimit perkates te njofojne menjihere dhe ti japin llogari Ortakut te vetem.

3. **Administratori ose Perfaquesuesi me Prokure**, jane individualisht perjegjes ndaj Shoqerise apo te treteve, per veprime te kryera ne shkelje te ligjeve dhe qe bien ne kundershtim me kete Statut dhe per demin e shkaktuar me FAJ, sipas rastit, Ortaku i vetem mund te ngrej Padi Civile dhe te kerkoj ndaj tyre shlyerjen e plete te demit te shkaktuar, perfshire dhe fitimin e munguar, duke patur njekohesisht dhe te drejten per te bere kallxim per ndjekje penale ne **PROKURORIN** e juridikcionit tokesor perkates.

#### **NENI 21**

Perfaqesimi i Shoqerise, ne mardheniet me te tretet si brenda vendit dhe jashte shtetit si rregull dhe per gjithesisht i perket Ortakut te vetem dhe Administratorit te Shoqerise.

#### **NENI 22**

Ortaku dhe Administratori i Shoqerise, ka te drejte qe per nevojat e ushtrimit normal te aktivitetit te Shoqerise, te marr ne pune specialiste dhe shtetas te ndryshem madhor dhe me zotesi te plete per te vepruar, duke lidhur Kontraten sipas kritereve qe parashikohen ne Kodin e Punes ne fuqi, te miratuar me Ligjin Nr.7961 dt.12.07.1995 dhe shtesat e mepasme plotesuese te tij dhe me Ligjin Nr.7703 dt.11.05.1993 "Per Sigurimet Shoqerore" si dhe ne perputhje me rregullat teknike dhe te disciplines profesionale te caktuara nga ana e punedhenesit.

**KREU IV:****BILANCI, te ARDHURAT DHE SHPERNDARJA E SHOQERISE****NENI 23**

Veprimet ekonomiko financiare te Shoqerise, mbyllen me daten **31 Dhjetor** te çdo viti.

Nxjerra e Bilancit finanziar vjetor, behet duke respektuar rregullat mbi Kontabilitetin dhe brenda 6 Muajeve nga data e mbylljes se vitit financiar.

Per nxjerrjen e rezultatit Kontabel te Shoqerise, mbi bazen e Aktivit dhe Pasivit nga me vendim te Ortakeve caktohet nje **Ekspert Kontabel i Autorizuar**.

Eksperti ka per detyre te kontrolloj dhe verifikoj te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimitarise Ekonomiko tregetare te Shoqerise, si ate gjithe vjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij, per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille mbi bazen e **Vendimit** te marre nga Ortaket e Shoqerise.

Ne perfundim te Kontrollit, Eksperti kontabel i autorizuar pergatit Raportin me shkrim per nxjerrjen e rezulatit perfundimtar te Bilancit finanziar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'japaraqes dhe dorezoj ne kohe Mbledhjes se Asamblese se Ortakeve, i cili eshte Organi i vetem per ti shqyrtuar dhe vendosur miratimin e tij.

**NENI 24**

Ortaket jane te detyruar qe te caktojne me vendim nje Ekspert Kontabel te Autorizuar ne rast se ne mbyllje te ushtrimit te aktivitetit financiar tejkalojne **2** prej **3** treguesve qe pervijojnë:

- a. Totali i Aktivit te Bilancit vjetor eshte 6.000.000 lek.
- b. Totali i te ardhurave vjetore te Shoqerise eshte 12.000.000 lek.
- c. Numuri mesatar i te punesuarve eshte 10 persona.

**NENI 25**

Nxjerra e rezultateve te Bilancit vjetor, duhet bere me saktesi dhe duke respektuar te gjitha rregullat qe percaktohen ne Ligjin mbi Kontabilitetin dhe atyre te sistemit te Tatim Taksave qe jane te detyrueshme per tu zbatuar nga çdo subjekt privat qe ushtron veprimitari tregtare.

**Eksperti Kontabel** i autorizuar perveç te drejtave, ka dhe keto **detyrime**:

1. Garanton Asamblen e Ortakeve se llogarite vjetore jane te rregullta dhe Bilanci eshte nxjerre me saktesi dhe konform rregullave te Ligjit "**Mbi Kontabilitetin**".

2. Te pasqyroj me vertetesi rezultatet e operacioneve te vitit te kaluar financiar dhe gjendjen reale financiare te Shoqerise ne mbylljen e vitit financiar te aktivitetit tregtar te saj.

3. Te verifikoj perputhjet me llogarite vjetore te Informacioneve te dhena nga Administratoret e Shoqerise ne Mbledhjet e Asamblese se Ortakeve, duke perfshire dhe dokumentat per gjendjen financiare qe ai (Administratori) i ka paraqitur Asamblese Ortakeve.

4. T'i beje te njojur Ortakeve dhe Administratorit te Shoqerise: Kontrollet dhe verifikimet qe jane bere prej tij per kontolle periodike ose vjetore, duke vene ne dukje parregullsive apo pasakesite e konstatuar, masat ligjore per rregullimin e tyre etj.



### **NENI 26**

Eksperti Kontabel i autorizuar eshte perjegjes ndaj Shoqerise dhe ndaj te treteve per pasojat e demeshme te shkaktuara me fajin e tij (Dashje ose pakujdesi) aktivitetit tregetar te Shoqerise, por nuk eshte perjegjes kur keto DEME shkaktohen pa dijenin e tij dhe nga veprimet me faj te Administratorit te Shoqerise.

### **NENI 27**

Bilanci Kontabel vjetor, miratohet mbi bazen e Vendimit me shkrim te marre nga Ortaket ne Mbledhjen e Asamblese se Ortakeve, ne te cilin jo vetem qe dokumentohet aprovin e tij por dhe qe percakton dhe ne lidhje me disponibilitetin e FONDEVE ligjore, sipas nevojave te zhvillimit te metejshem te aktivitetit te Shoqerise por dhe per GARANTIMIN e veprimtarise se rregullt te saj, duke patur parasyesh Fondin e Akumulimit, krijuimin e fondit te vecante etj.

Per Formimin e fondit rezevre, qe emertohet "**Rezerve e domosdoshme**" Ortaket vendosin qe nga fitimi i akumular gjate vitit financiar, pasi te zbriten humbjet e vitit te meparshem, te lere te pakten I/20 e vleres se Fitimit te realizuar.

### **NENI 28**

Te Ardhurat neto (Dividenti) qe mbeten pas vecimit te fondevit ligjore te mesiperme dhe te atyre per shlyerjen e cdo detyrimi tatimor e fiskal apo likuidimin e pagesave ose ekzekutimin e detyrimeve (debive) ndaj te treteve, i kalojne ne Pronesi, Ortakut te vetem themelues.

### **NENI 29**

Shperndarja ose Prishja e Shoqerise, mund te behet ne cdo kohe dhe per cfaredo shkaku, edhe para plotesimit te AFATIT per te cilin eshte krijuar Shoqeria sic mund te jene:

- a. Humbja e Kapitalit ose pamundesia e vazhdimit te metejshem te veprimtarise se saj.
- b. Ne nje nga menyrat e parashikuara nga Ligji " Per Falimentimin e Shoqerive Tregtar".
- c. Me kerkesen e njerit Ortak dhe kur kjo pranohet nga Mbledhja e Asamblese se Ortakeve.

Ne kete rast Ortaket, marrin Vendim me shkrim ne te cilin parashikojne dhe menyren e Likuidimit te Shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe leshuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e Likuidatorit dhe emertesen Shtese "Shoqeri ne likuidim e siper."

### **NENI 30**

Akti i Emerimit te Likuidatorit, Publikohet sipas kushteve qe parashikon Ligji perkates duke specifikuar dhe dokumentat qe duhen depozituar ne Aneksin e rregjistrat Tregtar.

### **NENI 31**

Likuidatori eshte i detyruar qe te jete i vemenshem dhe korekt si per realizimin e te drejtave per subjektet ndaj te cilave Shoqeria eshte Kreditore dhe per ekzekutimin e plote te detyrimeve (debive) qe Shoqeria ka ndaj shtetit, shtetasve te vecante, apo personave fizike ose juridik vendas apo te huaj.

### **NENI 32**

Cdo mosmarrveshje apo konflikt qe mund te lind gjate ushtrimit te veprimtarise se Shoqerise si rregull dhe per gjithesht Ortaku duhet ta zgjidh ne mirekuptim ne te kunderten ceshtjen mund ta bejne objekt Konflikti gjyqesor .

09.

Te drejten e ngritjes se Padise gjyqesore, ne rast konflikti civil, Ortaku e disponon ne menyre te pavarur, duke e ngritur ate ne **Gjykaten e rrithit Durres** ose ne **Gjykaten nderkombetare te PARISH**.

**NENI 33**

Persa nuk eshte shprehur ne kete Statut i referohet udhezimeve plotesuese e konform akteve ligjore e nenligjore ne fuqi, te dhena nga ana e Ortakeve te Shoqerise si dhe hapsirave juridike lejuese te **Legislacionit ne fuqi** dhe **normave nderkombetare**.

**NENI 34**

**Ky Statut** u redaktua ne 5 ekzemplare ne gjuhen shqipe, me permbajtje e vlera te njejtta juridike dhe pasi lexohet, miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket themelues te Shoqerise tregetare **“KASTRIOTI & PETROL” Shpk Durres** nenshkruehet prej tyre ne te gjithe ekzemplaret duke u vene emri, mbiemri dhe firma originale, autenticiteti i te cilave vertetohet dhe nga Noteri.

**ORTAKET THEMELUES**

TE SHOQERIS TREGTARE ME ORTAKERI

**“KASTRIOTI & PETROL” Shpk**

Durres – A l b a n i a

**Miratues i ketij S T A T U T I**

Shtetasit Shqipetar

1. z. Lulzim Capakullari  
Leonefe

2. z. Hijz Nergati  
Ary